



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit  
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. 788/2022  
Nr. fqi/Br.str./Nr.pg.  
Data/Datum/Date: 23/05/2022

PRISHTINË-PRIŠTINA PRISTINA



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

## OPINION

### I

## AVOKATIT TË POPULLIT

Ex officio nr. 39/2022

Vlerësimi i strukturës së re tarifore në Kosovë kundrejt të drejtave të njeriut

## Përbajtja

Hyrje .....	3
Historiku i tarifave të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës .....	4
Struktura tarifore nga viti 2007 deri në vitin 2017.....	4
Bllok-tarifa në sistemin energetik të Republikës së Kosovës.....	6
Subvencionimi nga Qeveria e Kosovës.....	12
Gjendja e të drejtave të tjera të konsumatorit në tregun e energjisë elektrike .....	17
Tarifat e konsumatorëve pa njehsor në raport me inkriminimin penal.....	17
Aspekti social - Sa është i përballueshëm nga qytetarët? .....	18
Masat që rrjedhin nga Ligji nr. 05/L-044 për Zonën e Rezikuar Mjedisore të Obiliqit .....	19
Vlerësimet e përgjithshme të Avokatit të Popullit.....	20
Përfundime .....	21

## Hyrje

Më 13 dhjetor 2021, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRR-E) hapi shqyrtimin e jashtëzakonshëm tarifor. ZRR-E-ja argumentonte se shtrenjtimi i çmimeve në tregjet ndërkombëtare kombinuar me rritjen e kërkesës së brendshme të energjisë e bënte të domosdoshme një rishikim të tarifave.

Duke qenë se prodhimi vendor nuk mund ta plotësonë tërë kërkesën për energji elektrike, paraqitej nevoja për import, që do t'i tekalonte sasitë e lejuara nga ZRR-E-ja gjatë shqyrtimit të rregullt tarifor. Importi shtesë paraqiste edhe kosto shtesë për operatorët, të cilat nuk ishin parashikuar në të hyrat e lejuara maksimale për vitin relevant tarifor 2021.<sup>1</sup>

Ky Opinion vlerëson ligjshmërinë dhe mbi të gjitha elementet e të drejtave të njeriut që mund të jenë shkelur me vendimin e ZRR-E-së për përcaktimin e strukturës tarifore në koordinim me përkushtimet e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës (më tej: Qeveria) për ta subvencionuar tarifën. Ne gjithashtu kemi shikuar praktikën e vendeve evropiane dhe të vendeve të tjera për përcaktimin e tarifave në tregje të rregulluara dhe të parregulluara.

Kosova është palë kontraktuese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë qysh nga viti 2006 dhe si e tillë duhet ta përafrojë dhe zbatojë legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE) i renditur në nenin 10 të Traktatit që themelon Komunitetin e Energjisë. Për më tepër, Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) e vitit 2016, sa i përket energjisë, e vendos Komunitetin e Energjisë në bazën e integrimit të Kosovës në tregjet energetike të BE-së. Neni 114 - Energjia thekson se bashkëpunimi do të fokusohet në fushat me prioritet që lidhen me *acquis* të Komunitetit në fushën e energjisë dhe do të bazohet në Traktat me qëllim të integrimit gradual të Kosovës në tregjet energetike të Evropës. Më tej priorititetet afatmesme të *acquis* it, Kapitulli 15 – Energjia, dhe Kapitulli 21.

Duke qenë palë nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, legjislacioni i zbatueshëm drejtpërdrejt në nivel të Komunitetit ka zbatim të drejtpërdrejtë në Kosovë. Ky legjislacion përfshin edhe dispozitat për promovim të konkurrencës së ndershme dhe qasje të lehtë përfshirë të ndryshëm dhe nxitja e kapaciteteve për prodhim të ri të energjisë elektrike duhet të jetë i një rëndësie të madhe për shtetet anëtare, në mënyrë që të lejohen konsumatorët të përfitojnë plotësisht nga mundësitë e një tregu të brendshëm të liberalizuar të energjisë elektrike.<sup>2</sup>

Kosova ndodhet gjithashtu përballë kontekstit të nënshkrimit të Deklaratës së Samitit të Sofjes për zbatimin e Agjendës së Gjelbër për Kosovën. Kjo deklaratë ndër të tjera bën thirrje që vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën, t'i informojnë konsumatorët dhe ta zbatojnë legjislacionin përmbylli miratimin e Strategjisë së Energjisë dhe të Planit Kombëtar për Energi dhe Klimë, dokumente këto që gjithashtu do t'i përshtypojnë reformat në tregun e energjisë përfshirë në dizajnin e tregut dhe promovimin e një tregu plotësisht konkurrues.

<sup>1</sup> Zyra e Rregullatorit për Energji (2021), Njoftim për medie në lidhje me hapjen e shqyrtimit të jashtëzakonshëm tarifor, Prishtinë: ZRR-E.

<sup>2</sup> THE ENERGY COMMUNITY LEGAL FRAMEWORK 4.2 Edition – faqe 69.

## **Historiku i tarifave të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës**

Viti 2022 ka gjetur tërë Evropën në një gjendje të rëndë kundrejt furnizimit me energji elektrike, duke krijuar në një krizë të përgjithshme energetike. Kjo krizë erdhi si rezultat i shumë faktorëve, duke filluar nga konsumi i lartë gjatë periudhës së izolimit nga pandemia COVID-19, rritja e vazhdueshme e kërkësës për energji elektrike, rritja e kërkësës për gaz nga kontinenti aziatik dhe niveli i ulët i rezervave të gazit në Evropë.<sup>3</sup>

Të gjithë faktorët e lartpërmendur patën ndikim edhe në sektorin e energjisë në Kosovë, të cilët përpos që cenuan ndjeshëm sigurinë me furnizim të energjisë elektrike, çuan edhe në ndryshim të strukturës tarifore dhe të imponimit të një çmimi më të lartë tek konsumatorët fundorë. Kjo situatë kërkoi një shqyrtim të jashtëzakonshëm të tarifave nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRR.E).

Ky shqyrtim ndodh vetëm në raste kur ka një mospërputhje të madhe (tejkalim të pragut të materialitetit 5%) mes vlerësimit të hyrave të supozuara gjatë procesit të vendosjes së tarifave dhe gjatë implementimit të tyre.<sup>4</sup> Struktura e re tarifore është e treta me radhë e zbatuar në Kosovë. Ky kapitull do të shtjellojë në mënyrë kronologjike vendosjen e tri strukturave tarifore nga viti 2007 deri në vitin 2022.



### ***Struktura tarifore nga viti 2007 deri në vitin 2017***

Në vitin 2007 u vendos struktura e parë tarifore, e cila u aplikua deri në vitin 2017 duke bërë kështu strukturën më të gjatë të zbatimit në Kosovë. Kjo strukturë tarifore u projektua duke u bazuar në disa funksione, konkretisht mbi 1) kohën e përdorimit, 2) sezonalitetin dhe 3) bllokun progresiv tarifor.<sup>5</sup> Këto funksione janë të përshkruara në detaje më poshtë.

Në funksionin e parë - atë të kohës së përdorimit, qëllimi kryesor ishte që konsumatori ta mënjanonte konsumin më të madh gjatë kohës së shfrytëzimit maksimal, duke lehtësuar tarifat gjatë periudhës së natës dhe duke nxitur konsumin gjatë këtij intervali të ditës. Në funksionin e dytë - atë të sezonalitetit, praktika e njëjtë është përdorur duke shtyrë konsumatorët që ta shfrytëzonin në mënyrë racionale dhe më efikase energjinë elektrike gjatë periudhës së dimrit. E fundit, por jo më pak e rëndësishme - funksioni i bllokut progresiv tarifor - impononte një çmim më të lartë në sasi më të mëdha të konsumit të energjisë

<sup>3</sup> Zyra e Rregullatorit të Energjisë (2022). "Raport Konsultativ Shqyrtimi i Strukturës Tarifore për Konsumatorët e Rregulluar të Amvisërive të shërbyer nën FSHU", faqe 6, e qasshme në: [https://www.ero-ks.org/zrr.e/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Raport%20konsultative%20per%20strukturen%20tarifore\\_1.pdf](https://www.ero-ks.org/zrr.e/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Raport%20konsultative%20per%20strukturen%20tarifore_1.pdf)

<sup>4</sup> Po aty.

<sup>5</sup> Po aty, faqe 12.

elektrike, i cili mendohej të kontribuonte në një konsum i cili ka kosto të përballueshme për konsumatorët dhe ngrë nivelin e eficiencës së energjisë.

Blloku progresiv tarifor gjatë periudhës 2007 deri 2017 dukej kështu:

Brezi i konsumit (kWh/muaj)	Çmimi (cent/kWh)	Sezoni i dimrit	Sezoni i verës
0 – 200	Tarifa e lartë	5.55	3.99
	Tarifa e ulët	2.79	1.99
200 – 600	Tarifa e lartë	7.70	5.51
	Tarifa e ulët	3.86	2.76
> 600	Tarifa e lartë	11.17	8.00
	Tarifa e ulët	5.58	4.01

Tabela 1. Struktura e blloqueve tarifore prej 2007 deri 2017<sup>6</sup>

Kjo strukturë, e cila ishte në fuqi deri në vitin 2017, ndryshoi nga ky vit. Në vitin 2017 struktura tarifore e re mbeti në fuqi deri në vitin 2021, atëherë kur Kosova u ballafaqua me një krizë energetike dhe rritje të çmimeve. Struktura e dytë në fuqi ishte më e thjeshtë se ajo paraprakja. Kjo e fundit largoi funksionet 2) sezonaliteti dhe 3) blloku progresiv tarifor, ndërkaq vendosi një tarifë fikse për muaj për konsumatorë, e cila ishte 1.74 EUR, me një tarifë të lartë prej 6.75 cent/kWh dhe me tarifë të ulët prej 2.89 cent/kWh<sup>7</sup>. Kjo tarifë ishte në fuqi deri në fund të vitit 2021.

Në pjesën e dytë të vitit 2021 u shfaqën indikatorët e parë, të cilët paralajmëruan krisjen energjetike që do të prekte Kosovën në fillim të vitit 2022. Duke llogaritur se shpenzimet e ndërmarrjeve energjetike tejkalan shifrat e planikuara, më 28 tetor të 2021 KEDS-i dhe KESCO-ja parashtruan kërkesë për shqyrtim të jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) tek ZRR-E-ja.<sup>8</sup> Sipas kësaj kërkesë, KEDS-i dhe KESCO-ja potenconin se arsyet e rishqyrtimit të tarifave erdhën si rrjedhim i rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare si dhe të konsumit të lartë vendor.<sup>9</sup> Sipas argumenteve të parashtruara nga ndërmarrjet energjetike si dhe nga përllogaritjet e fundit të procesit tarifor, ZRR-E-ja hapi shqyrtim të jashtëzakonshëm.<sup>10</sup> Si rezultat i vënies në konsultim publik të Raportit konsultativ, ZRR-E-ja vendosi më 9 shkurt 2022 strukturën e re tarifore, e cila do të jetë në fuqi deri më 31 mars 2023.

Sipas strukturës së re tarifore, rikthehen bllonet tarifore dhe vazhdohet aplikimi i tarifës mbi kohën e përdorimit. Blloku tarifor në strukturën e re tarifore u vendos në 800 kWh, ndërkaq tarifa e lartë u vendos në 21 cent/kWh dhe tarifa e ulët në 9 cent/kWh.<sup>11</sup> Krahasimi i funksioneve për secilën strukturë tarifore nga 2007-a deri më 2022 është paraqitur më poshtë:

<sup>6</sup> Po aty, faqet 11 & 12.

<sup>7</sup> Po aty, faqe 13.

<sup>8</sup> Zyra e Rregullorit të Energjisë (ZRR-E) 2021. "Shqyrtim i Jashtëzakonshëm i të Hyrave të Lejuara Maksimale për Operatorët e Rregulluar", paragrafi 2, e qasshme në: <https://www.ero-ks.org/zre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Shqyrtim%20i%20Jashtezakonshem%20i%20Te%20Hyrave%20te%20Lejuara%20maksimale%20per%20Operator...pdf>

<sup>9</sup> Po aty.

<sup>10</sup> Po aty, paragrafi 6.

<sup>11</sup> Zyra e Rregullorit të Energjisë (ZRR-E) (2022). "Raport përfundimtar për Strukturën Tarifore të Konsumatorëve të Rregulluar të Energjisë Elektrike: Përgjigje ndaj Komenteve", faqe 22, e qasshme në <https://www.ero-ks.org>

	<b>Struktura tarifore (2007 – 2017)</b>	<b>Struktura tarifore (2017 – 2021)</b>	<b>Struktura tarifore (2022 – 2023)</b>
<b>Koha e përdorimit</b>	Po	Po	Po
<b>Sezonaliteti</b>	Po	Jo	Jo
<b>Bllok-tarifa</b>	Po	Jo	Po

Kapitulli pasues do të shpjegojë se si kjo strukturë tarifore garanton të drejtat e konsumatorëve dhe sa prej tyre shkelen.

### **Bllok-tarifa në sistemin energetik të Republikës së Kosovës**

Bllok-tarifa është sistem përmes të cilit bëhet kategorizimi i çmimit të energjisë elektrike duke u bazuar në sasinë e shfrytëzuar të energjisë elektrike. Kategorizimi është i atillë ku për sasinë e energjisë së blllokut të parë çmimi i energjisë elektrike është më i lirë, ndërsa me kalimin në bllonet e tjera, edhe çmimi i energjisë pëson ngritje. Në këtë mënyrë çmimi është më i përballueshëm për konsumatorët që e shfrytëzojnë për nevoja esenciale energjinë elektrike dhe inkurajon kursimin e energjisë për të gjithë konsumatorët në të gjitha bllonet.

Në Republikën e Kosovës bllok-tarifa është përdorur për të kursyer energjinë elektrike, për të krijuar stabilitet social për konsumatorët me të hyra më të ulëta dhe për të ofruar efikasitet për sistemin elektroenergetik. Duke e ditur që vendi ynë nuk mund t'i plotësojë kërkesat për energji elektrike nga prodhimi i brendshëm (kapacitetet vendore), bllok-tarifa është përdorur edhe më herët, në atë mënyrë që konsumi i përgjithshëm i energjisë elektrike të reduktohej, duke bërë që të mos kishte varësi të mëdha nga importi i energjisë elektrike përmes bursave ndërkombëtare të energjisë.<sup>12</sup> Rivendosja e bllok-tarifës në sistemin energetik të Republikës së Kosovës ka qenë e kuptueshme dhe e mirëpritur nëse do të vendosej për të kursyer energjinë elektrike, por kjo nuk paraqitej në arsyetimin e ZRrE-së.

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRrE) ka theksuar që përcaktimi i kufirit prej 800 kWh të energjisë elektrike të shpenzuar për muaj është si rrjetësi i kapaciteteve të prodhimit të brendshëm e jo si masë për të stimuluar kursimin e energjisë elektrike apo shtimin e masave të eficiencës së energjisë nga ana e konsumatorëve.<sup>13</sup> Madje në komentet e dërguara tek ZRrE-ja edhe nga ana e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë tekstualisht është theksuar kështu:

[ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Rapor%C3%ABrfundimtar%C3%ABr%20Struktur%C3%ABn%20Tarifore\\_P%C3%ABrqjigje%20ndaj%20Komenteve.pdf](https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Rapor%C3%ABrfundimtar%C3%ABr%20Struktur%C3%ABn%20Tarifore_P%C3%ABrqjigje%20ndaj%20Komenteve.pdf)

<sup>12</sup> Zyra e Rregullatorit të Energjisë, Konsultime Publike, Raport konsultativ për Strukturën Tarifore, e qasshme në [https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Rapor%C3%ABrfundimtar%C3%ABr%20Struktur%C3%ABn%20Tarifore\\_P%C3%ABrqjigje%20ndaj%20Komenteve.pdf](https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Rapor%C3%ABrfundimtar%C3%ABr%20Struktur%C3%ABn%20Tarifore_P%C3%ABrqjigje%20ndaj%20Komenteve.pdf)

[ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Rapor%C3%ABrfundimtar%C3%ABr%20Struktur%C3%ABn%20Tarifore\\_1.pdf](https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Rapor%C3%ABrfundimtar%C3%ABr%20Struktur%C3%ABn%20Tarifore_P%C3%ABrqjigje%20ndaj%20Komenteve_1.pdf), (qasur në mars, 2022)

<sup>13</sup> Zyra e Rregullatorit të Energjisë, Konsultime Publike, Raport përfundimtar për Strukturën Tarifore - Përgjigje ndaj Komenteve, e qasshme në [https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Rapor%C3%ABrfundimtar%C3%ABr%20Struktur%C3%ABn%20Tarifore\\_P%C3%ABrqjigje%20ndaj%20Komenteve.pdf](https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Rapor%C3%ABrfundimtar%C3%ABr%20Struktur%C3%ABn%20Tarifore_P%C3%ABrqjigje%20ndaj%20Komenteve.pdf),

(qasur në mars, 2022)

*“Ne mbështesim plotësisht futjen në përdorim të ‘bllok-tarifës’ si një masë për të stimuluar kursimin e energjisë elektrike dhe për të ngarkuar më shumë për energjinë elektrike të konsumuar mbi një prag të caktuar.”*

Ndërsa ZRR-E-ja ka arsyetuar vendosjen e bllok-tarifës në nivelin 800 kWh si pasojë e prodhimit të brendshëm (kapaciteteve vendore), i cili mund të mbulojë sasinë e lartpërmendur, ndërsa pjesa tjetër e shpenzuar mbi nivelin prej 800 kWh duhet të importohet.

Me vendosjen e bllok-tarifës, konsumatorët janë pjesë e kategorizimit të çmimeve të energjisë elektrike. Ndryshimet e çmimeve të bazuara në konsum paraqesin avantazhe specifike në çmim, pasi për të njëtin produkt (energji elektrike) konsumatorët që shpenzojnë deri në 800 kWh të energjisë elektrike në muaj paguajnë më lirë çmimin për kWh, ndërsa për konsumatorët që shpenzojnë mbi nivelin prej 800 kWh të energjisë elektrike në muaj aplikohen çmime të ngritura për çdo kWh të shpenzuar. Ligji nr. 2004/18 për Tregtinë e Brendshme<sup>14</sup>, në nenin 48 – Veprimet keq drejtuese, në pikën c, thekson:

*“Çmimi ose mënyra e llogaritjes së çmimit ose ekzistencë e avantazheve specifike në çmim (nevoja për një shërbim, pjesë, zëvendësim apo riparim).”*

Sipas Ligjit nr.2004/18 për Tregtinë e Brendshme, një metodë e tillë e aplikuar përmes vendosjen së bllok-tarifës, ku bëhet diferencimi i çmimeve, paraqet veprim keqdrejtues dhe joadekuat kundrejt konsumatorit.

Bllok-tarifa nuk është e përfshirë as në Ligjin nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike<sup>15</sup> i Republikës së Kosovës. Si metodologji e përdorur edhe më parë, edhe pse nuk është e përfshirë në këtë ligj, bllok-tarifa nuk rregullohet me ligjin i cili ka për qëllim të përcaktojë rregulla dhe masa përfunksionimin e sektorit të energjisë elektrike, pra me Ligjin nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike. Ndër të tjera, bllok-tarifa është në kundërshtim me pikën 3 të nenit 48 (Mbrojtja e Konsumatorit) të po këtij ligji. Kjo pikë e ligjit thekson:

*“Derisa kryen aktivitetet e punës së tij, furnizuesi duhet të veprojë në atë mënyrë që të sigurojë pozitë të barabartë të konsumatorëve të energjisë elektrike.”*

Ky nen i Ligjit nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike është lehtësish i kuptueshëm dhe thekson qartë se konsumatorët janë të barabartë, nuk bëhen diferencime mes tyre dhe qëndrojnë pa privilegje sa u përket vendimeve në sistemin energetik të Republikës së Kosovës.

Bllok-tarifa si një metodologji për balancim të sistemit energetik të Republikës së Kosovës paraqitet edhe kundër pikave të Ligjit nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë<sup>16</sup>. Përmes këtij ligji, i cili përcakton kompetencat, detyrat dhe funksionet e ZRR-E-së, e gjithashtu ofron mbrojtje ndaj konsumatorit, si dhe përcakton kriteret përfregullimin e tarifave dhe kushtet përfurnizim me energji, mund të vërehen pikat në të cilat bllok-tarifa bie në kundërshtim. Pika 1.14 e nenit 15 - Detyrat dhe përgjegjësitë e Rregullatorit thekson:

*“Të ndihmojë në mënyrën më efikase në sigurimin e zhvillimit të sistemeve të sigurta, të besueshme, efikase dhe jodiskriminuese, të cilat janë të orientuara kah konsumatori dhe ta*

<sup>14</sup> Gazeta Zyrtare e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë, Ligji nr. 2004/18 për Tregtinë e Brendshme, e qasshme në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2473> , (qasur në mars, 2022).

<sup>15</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, e qasshme në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12744> , (qasur në mars, 2022).

<sup>16</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, e qasshme në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12694> , (qasur në mars, 2022).

*promovojë në mënyrë adekuat sistemin, në pajtim me objektivat e përgjithshme të politikave të energjisë, të eficiencës së energjisë dhe të integrimit të stabilimenteve të mëdha dhe të vogla të prodhimit nga burime të ripërtëritshme të energjisë dhe prodhimi i shpërndarë edhe në rrjetin e transmetimit, edhe në atë të shpërndarjes.”*

Ndarja e konsumatorëve në bazë të nivelit të konsumit, duke e ditur që produkti është i njëjtë (energjia elektrike), paraqet diskriminim dhe bie në kundërshtim me pikën 1.14 të nenit 15 - Detyrat dhe përgjegjësitet e Rregullatorit, të Ligjit nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë.

Tarifat e ndryshme e të bazuara në nivel të konsumit të energjisë elektrike janë në kundërshtim edhe me pika të tjera të Ligjit nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë. Përkatesisht në nenin 47 – Metodologjia e tarifave<sup>17</sup>, në pikën 3.1, theksohet:

*“Tarifat të jenë të arsyeshme, **jodiskriminuese**, të bazuara në kriterje objektive, përfshirë ato të përcaktuara në nenin 15 paragrafin 5 të këtij ligji si dhe të vendosura në mënyrë transparente.”*

Bazuar në atë që tarifat e aplikuara në sistemin energetik të Republikës së Kosovës nga data 9 shkurt 2022 janë të ndryshme nëpër kategori të konsumit, kjo paraqet diskriminim dhe shkelje të kësaj pike të nenit 47 – Metodologjia e tarifave.

Paragrafi 4 i nenit 15 - Detyrat dhe përgjegjësitet e Rregullatorit, të Ligjit nr. 05/L-084	Zbatimi në rastin e vendimit për shtrenjtësim të frysës
<p>4.1. Siguron që kategori të ndryshme të konsumatorëve të mos përfitojnë nga i njëjti trajtim dhe mbrojtje, si dhe rregullimi i çmimit të konsumit fundor të jetë në dispozicion vetëm për të siguruar ofrimin e shërbimit universal për konsumatorët familjarë dhe konsumatorët që gjëzojnë të drejtën e shërbimit universal.</p>	<p><b>E aplikuar</b></p> <p>Në frysë e Direktivës 2019/944 të BE-së, vendimi i ZRR-së shkel parimin e ndalimit të ndërhyrjes së shtetit me subvencionim diskriminues mes konsumatorëve me çmim të furnizimit të rregulluar.<sup>18</sup></p>
<p>4.2. Siguron që çmimet e energjisë elektrike që i nënshtron rregullimit të çmimeve për qëllim të sigurimit të shërbimit universal ta reflekojnë koston. Reflektimi i kostos duhet ta mbulojë koston reale të furnizimit të energjisë elektrike, duke përfshirë koston e gjenerimit, koston marginale afatshkurtër, duke reflektuar portofolin e plotë të gjenerimit, investimet e domosdoshme, shkallën e duhur të kthimit, koston e</p>	<p><b>E aplikuar</b></p>

<sup>17</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, nen 47, e qasshme në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12694>, (qasur në mars, 2022).

<sup>18</sup> Direktiva e BE-së nr. 2019/944 – nen 5.

importeve, koston e shërbimeve të furnizimit, si dhe borxhet e këqija.	
4.3. Në vendimin e tij për rregullimin e çmimeve për konsumatorët fundorë, Rregulatori përcakton një datë të fundit për heqjen e rregullimit të çmimeve të konsumatorëve fundorë, si dhe një plan veprimi për ta kryer këtë, duke shfaqur qartë natyrën e përkohshme të rregullimit të çmimeve për shfrytëzuesit fundorë.	Nuk është aplikuar, pasi nuk është përcaktuar data e fundit për heqjen e rregullimit të çmimeve të konsumatorëve fundorë, e as një plan veprimi për ta arritur atë.
4.4. Bën rishikime vjetore të metodologjive dhe të nivelit të miratuar të çmimeve për konsumatorët fundorë, si dhe shqyrton nevojën e domosdoshmërisë së rregullimit të çmimit për kategorinë të caktuara të konsumatorëve, në bazë të objektivit të shërbimit publik të ndjekur. Këto rishikime i dorëzohen Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, i cili, në bazë të analizës së tregut rafional, mund të propozojë masa të tjera për heqjen e rregullimit të çmimeve për kategorinë të caktuara të konsumatorëve.	<b>E aplikuar</b>
4.5. Siguron pajtueshmërinë e operatorëve të sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes dhe, kurdo që kjo është relevante, të pronarëve të sistemit, si dhe të gjitha ndërmarrjeve të tjera të gazit natyror dhe të energjisë elektrike, me obligimet e tyre sipas këtij Ligji, Ligjit për Energjinë, Ligjit për Energjinë Elektrike dhe Ligjit për Gazin Natyror, duke i përfshirë dispozitat lidhur me çështjet ndërkuftare.	<b>E aplikuar</b>

Blllok-tarifa është aplikuar më herët vetëm në disa shtete të zhvilluara, e në të cilat sot kjo metodologji e sistemit energetik nuk aplikohet më. Ndër shtetet e zhvilluara që ka aplikuar blllok-tarifën ka qenë edhe Italia. Italia filloi aplikimin e blllok-tarifës qysht në vitin 1970, si pasojë e krizës së naftës dhe reduktimit të kërkesës dhe për arsyen sociale.<sup>19</sup> Struktura progresive e tarifës apo blllok-tarifa ka qenë e detyrueshme në Itali për të gjithë konsumatorët,

<sup>19</sup> PROGRESSIVE TARIFFS FOR RESIDENTIAL ELECTRICITY CONSUMPTION. AN OPTION FOR GERMANY? , e qasshme në [http://climatepolicyinitiative.org/wp-content/uploads/2011/12/Tews\\_Progressive-Tariffs-for-Residential-Electricity-Consumption.pdf](http://climatepolicyinitiative.org/wp-content/uploads/2011/12/Tews_Progressive-Tariffs-for-Residential-Electricity-Consumption.pdf), (qasur në mars, 2022).

pavarësisht nga furnizuesi. Por duke parë direktivat e reja, të fokusuara nga burimet e ripërtëritshme, dhe politikat të cilat synonin avancimin e sektorit energetik, Italia vendosi që për gjatë periudhës 2016-2017 të bënte reformën e sistemit energetik në mënyrë që t'i tejkalonte problemet e ndërlidhura me bllok-tarifën.<sup>20</sup> Një arsyé tjetër e largimit të bllok-tarifës ishte edhe vjetërsia e një metodologjje të tillë në një sektor i cili dita-ditës po avancohej dhe po digitalizohej edhe më shumë.

Në atë kohë Italia, si shumë vende të tjera evropiane, po përballej me pasojat e një krize nafte dhe kishte një nevojë të shtuar t'i inkurajonte kursimet e energjisë në të gjithë sektorët. Për më tepër, një zhvillim i shpejtë i rrjetit të gazit natyror po ndodhë në Itali për të nxitur përdorimin e këtij sistemi efikas të energjisë jo vetëm në sektorin industrial, por edhe për ngrohjen dhe gatimin në sektorin e banesave. Shpërndarja e shpejtë e gazit natyror ishte në atë kohë një arsyé tjetër për të mbështetur përdorimin e energjisë elektrike në shtëpi vetëm për “përdorime të detyrueshme” (ndriçim dhe pajisje) dhe jo për përdorime termike.

Italia përcaktoi edhe maksimumin e energjisë së shfrytëzueshme nga ana e konsumatorëve. Dy struktura të ndryshme tarifore u përcaktuan për familjet: një përfurnizimin e shtëpive të banimit parësor me përdorim të kufizuar të energjisë (jo më shumë se 3.3 kWh) dhe një më i lartë përkonsumentorët më intensivë (me një kapacitet të shfrytëzimit më të lartë se 3.3 kW).<sup>21</sup> E gjithë kjo përsye të kursimit të energjisë elektrike dhe shfrytëzim të saj vetëm për “përdorimet e detyrueshme”.

Struktura tarifore për grupin e parë (konsumatorët që përbën shumicën e familjeve italiane) është projektuar si një “tarifë progresive”. Kufijtë e poshtëm dhe të sipërm të çdo blloku u përcaktuan (në terma kWh/vit ose në kWh/muaj përfaturimin mëqorr). Këta ishin atëherë kufijtë e tri bloqeve:

1. Deri në 900 kWh/vit për aplikimin e çmimit më të ulët.
2. 901-1800 kWh/vit për çmimin mesatar.
3. Mbi 1800 kWh/viti për çmimin më të lartë.

Gjatë 45 viteve në vijim, numri i bloqeve u rrit nga tre në katër/pesë dhe forma e çmimeve për çdo bllok ndryshoi disa herë, bazuar edhe në zhvillimin ekonomik dhe ngjarjet që karakterizonin sektorin e energjisë në Itali. Më poshtë është paraqitur tabela me të dhëna rreth transformimit të bllok-tarifës në sistemin energetik të Italisë për gjatë viteve<sup>22</sup> (shprehur në përqindjen e çmimit më të lartë të aplikuar).

Viti	0-900 kWh/vit	901-1800 kWh/vit	1801-2640 kWh/vit	2641-3549 kWh/vit	3541-4440 kWh/vit	4441 dhe më tepër
1991	29%	62%	100%	100%	100%	100%
2000	21%	29%	50%	100%	92%	50%

<sup>20</sup> ARERA, Publications, Annual Report, 2016, e qasshme në

[https://www.arera.it/allegati/relaz\\_ann/16/ReportBortoni\\_2016.pdf](https://www.arera.it/allegati/relaz_ann/16/ReportBortoni_2016.pdf), (qasur në mars, 2022).

<sup>21</sup> CEER, Council of European Energy Regulators, Electricity Distribution Network Tariffs CEER Guidelines of Good Practice, e qasshme në <https://www.ceer.eu/documents/104400/-/1bcd6307-7f9a-c6de-6950-f19873959413>, (qasur në mars, 2022).

<sup>22</sup> Po aty.

<b>2007</b>	32%	40%	61%	100%	92%	61%
<b>2015</b>	43%	43%	62%	85%	85%	100%

Bllok-tarifa në Itali filloi të largohej nga sistemi energetik për gjatë periudhës 2016-2017. Parlamenti dhe Qeveria e Italisë identifikuan strukturën ekzistuese të tarifave të energjisë elektrike për familjet si jo në përputhje me objektivat e përmendura më poshtë:

- Është joefektive për promovimin e teknologjive efikase të ngrohjes dhe gatimit pasi aplikon një barrë të pajustifikuar mbi kostot e funksionimit të pompave efikase të nxehësisë, automjeteve elektrike dhe pllakave me induksion.
- Nuk reflekton koston dhe pengon përdoruesin në kryerjen e një krahasimi ekonomik neutral midis teknologjive të njëkohshme të bazuara në sektorin e energjisë.
- Bllok-tarifa pengon transparencën dhe ndërgjegjësimin e përdoruesve, pasi blloqet e çmimeve i bëjnë faturat e energjisë jashtëzakonisht komplekse për t'u lexuar dhe të vështira për t'u kuptuar, duke i penguar njerëzit të kenë një ide të qartë për çmimin që paguajnë për çdo kWh dhe më pas për përfitimet që mund të përfitojnë nga një investim në eficencën e energjisë.

Bllok-tarifa në ditët e sotme aplikohet ende, por vendet që e aplikojnë atë janë vende më pak të zhvilluara dhe me problematika sociale. Kjo pasi vendet e zhvilluara tashmë kanë liberalizuar tregun e energjisë elektrike, janë në linjë me direktivat dhe ofrojnë më shumë mundësi për mbarëvajtjen e sektorit të energjisë. Ndërsa disa prej vendeve të cilat edhe sot aplikojnë bllok-tarifën, janë:

**Cape Town** – kryeqytet i Afrikës së Jugut

**Langeberg** – komunë në Afrikën e Jugut

Në Cape Town aplikimi i bllok-tarifës ka bërë që niveli i konsumit prej 600 kWh të bënte diferençimin e konsumatorëve. Për nivelin 0 - 600 kWh të energjisë elektrike të shpenzuar në muaj, konsumatorët në amvisëri duhet të paguajnë 0.16 €/kWh, ndërsa për çdo kWh të energjisë elektrike mbi nivelin prej 600 kWh të energjisë elektrike të shpenzuar në muaj, konsumatorët në amvisëri duhet të paguajnë 0.20 €/kWh.<sup>23</sup> Duke ditur që në Afrikën e Jugut zhvillimi ekonomik është më i ulët dhe me problematika në aspektet sociale, aplikimi i bllok-tarifës synon të balancojë problemet sociale dhe të sigurojë furnizim me çmim të përballueshëm duke synuar në të njëjtën kohë të kursejë energji elektrike.

Langeberg, komunë në Afrikën e Jugut, gjithashtu aplikon sistemin e bllok-tarifës në sistemin energetik të tyre.<sup>24</sup> Mirëpo në këtë komunë ndarja bëhet në katër blloqe, siç janë:

1. Blloku i parë përfshin konsumatorët që shpenzojnë 0 - 50 kWh energji elektrike në muaj dhe kostoja për çdo kWh të shpenzuar është 0.05 €/kWh.

<sup>23</sup> City of Cape Town, UNDERSTANDING RESIDENTIAL ELECTRICITY TARIFFS IN CAPE TOWN – 2021/22, e qasshme në <https://resource.capetown.gov.za/documentcentre/Documents/Procedures,%20guidelines%20and%20regulations/Understanding-residential-electricity-tariffs.pdf>, (qasur në mars, 2022).

<sup>24</sup> Langeberg Municipality, Understanding Incline Block Tariffs for Prepaid Meters, e qasshme në <https://www.langeberg.gov.za/component/content/article/198-front-page-articles-1/front-page-articles/389-incline-block-tariffs-for-prepaid-meters?Itemid=158>, (qasur në mars, 2022).

- Blloku i dytë përfshin konsumatorët që shpenzojnë 51 - 350 kWh energji elektrike në muaj dhe kostoja për çdo kWh të shpenzuar është 0.066 €/kWh.
  - Blloku i tretë përfshin konsumatorët që shpenzojnë 351 - 600 kWh energji elektrike në muaj dhe kostoja për çdo kWh të shpenzuar është 0.092 €/kWh.
  - Blloku i katërt përfshin konsumatorët që shpenzojnë më shumë se 600 kWh energji elektrike në muaj dhe kostoja për çdo kWh të shpenzuar është 0.10 €/kWh.

Duke parë edhe aplikimet nga vendet e tjera, mund të vërejmë se krahas kursimit të energjisë elektrike, një nga arsyet kryesore të aplikimit të bllok-tarifës është arritja e “paqes sociale” duke bërë ngritjen graduale të çmimit të energjisë në bazë të nivelit të konsumit. Në këtë formë edhe Republika e Kosovës tashmë ka rikthyer sistemin tarifor me blloqe, duke bërë dallim të çmimit të energjisë elektrike në nivelin nën 800 kWh dhe mbi 800 kWh. Mirëpo sistemi i tillë bie ndesh me disa nga pikat e ligjeve të cituara më lart.

### **Konstatimet:**

1. Rivendosja e bllok-tarifës në sistemin energetik të Republikës së Kosovës ka qenë e kuptueshme dhe e mirëpritur nëse vendoset për të kursyer energjinë elektriqe, por kjo nuk paraqitej në arsyetimin e ZRrE-së.
  2. Sipas ZRrE-së, përcaktimi i kufirit prej 800 kWh të energjisë elektriqe **nuk** vjen si masë për të stimuluar kursimin e energjisë elektriqe apo i shtimit të masave të eficiencës së energjisë nga ana e konsumatorëve.
  3. **Shkeljet potenciale ndaj konsumatorëve, në bazë të legjislacionit:**
    - a. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (Neni 24 - Barazia para Ligjit).
    - b. Ligji nr. 2004/18 për Tregtinë e Brendshme.
    - c. Ligjin nr. 05/L-085 për Energjinë Elektriqe.
    - d. Ligjit nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë.

## **Subvencionimi nga Oeyeria e Kosovës**

Rritja e çmimit të energjisë në mënyrë që t'i mbulojë të hyrat përfurnizim me energji elektrike mund të paraqesë probleme përkonsumentorët në përballimin e pagesës. Kjo pasi përnjë pjesë të konsumentorëve tarifat e ngritura mund të paraqesin vështirësi në kryerjen e obligimeve financiare ndaj tyre. Faktor i rëndësishëm është edhe mosfunktionalizimi i Fondit të Konsumentorëve në Nevojë. Andaj kjo paraqet një shqetësim dhe problematikë që të reflektojë në jetesën e qytetarëve.

Për t'i mbuluar kostot në rritje për blerjen e energjisë dhe për ta ulur ndikimin e tarifave të energjisë te konsumatorët, Qeveria në mbledhjen e 60-të mori vendim për ndarjen e shumës prej 90.000.000.00 € (90 milionë euro).<sup>25</sup> Këto mjete i bashkëngjiten shumës prej

<sup>25</sup> Zyra e Rregullatorit të Enerjisë, Konsultime Publike, Raport përfundimtar për Strukturën Tarifore - Përgjigje ndaj Komenteve, Tarifat pas subvencionit të Qeverisë së Kosovës, e qasshme në [https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Raport%20p%C3%ABrfundimtar%20p%C3%ABr%20Struktur%C3%ABn%20Tarifore\\_P%C3%ABrgjigje%20ndaj%20Komenteve.pdf](https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Pjesemarresit%20ne%20Treg/Furnizim/Raport%20p%C3%ABrfundimtar%20p%C3%ABr%20Struktur%C3%ABn%20Tarifore_P%C3%ABrgjigje%20ndaj%20Komenteve.pdf), (casur në mars 2022).

10.000.000.00 € (10 milionë euro) të ndara më herët nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës për përballimin e ngritjes së çmimeve të energjisë elektrike dhe sigurimin e furnizimit me energji elektrike. Subvencionimi i tillë nga ana e Qeverisë reflekton drejtpërdrejt në ndryshim të çmimeve të propozuara nga ana e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRrE).

Skenari pa subvencionimin nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Skenari me subvencionimin nga Qeverisë e Republikës së Kosovës
Rritje prej 21% të komponenteve të energjisë të tarifave të konsumatorëve biznesorë.	Rritje prej 0% të komponenteve të energjisë elektrike të tarifave të konsumatorëve biznesorë.
Rritje prej 21% të tarifave të energjisë së konsumatorëve shtëpiakë për nivelin e konsumit deri në 800 kWh.	Rritje prej 0% të tarifave të energjisë elektrike për konsumatorët shtëpiakë për nivelin e konsumit deri në 800 kWh.
Aplikim të tarifës prej 0.21 €/kWh për energjinë e konsumuar në kohën e tarifës së lartë dhe 0.09 €/kWh për energjinë e konsumuar në tarifën e ulët.	Aplikim të tarifës prej 0.1252 €/kWh për energjinë elektrike të konsumuar në kohën e tarifës së lartë dhe 0.059 €/kWh për energjinë e konsumuar në tarifën e ulët.

Dukë marrë parasysh mjetet e ndara nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës përmes subvencionimit, rritje të çmimit të faturave të energjisë elektrike do të pësojnë vetëm disa kategori, ndërsa disa kategori të tjera nuk do të ndikohen nga vendimet e ZRrE-së. Në këtë mënyrë konsumatorët e amvisërisë që shpenzojnë më pak se 800 kWh energji elektrike në muaj nuk do të pësojnë ndryshime të çmimeve në faturat e tyre, ndërsa konsumatorët e amvisërisë që shpenzojnë më shumë se 800 kWh energji elektrike në muaj do të preken nga ngritja e çmimeve.

Konsumatori	A	B	C	D	E
<b>Konsumi më i ulët</b>	300 kWh	450 kWh	600 kWh	800 kWh	1000 kWh
<b>Fatura sipas tarifave të reja</b>	18.87 €	27.37 €	35.86 €	47.19 €	68.64 €
<b>Rritja</b>	0 €	0 €	0 €	0 €	10.12 €

Energjia elektrike duhet të konsiderohet si një produkt esencial pa të cilin nuk mund të zhvillohet jetesa dhe për të cilin duhet paguar çmimi i njëjtë, pa u bazuar në sasinë e shpenzuar. Marrë për bazë këtë, shtrenjtimi i sasisë së energjisë atëherë kur kalohet niveli i konsumit prej 800 kWh energji elektrike në muaj paraqet shkelje të të drejtave të njeriut, kjo edhe për faktin se vendosja e bllok-tarifës në nivelin e konsumit prej 800 kWh energji elektrike në muaj nuk arsyetohet nga ana e ZRrE-së si masë stimuluese e kursimit të energjisë elektrike, por si pasojë e mosarritjes së plotësimit të kërkesës nga ana e prodhimit të brendshëm të energjisë elektrike të Republikës së Kosovës.

Subvencionimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës mbulon në tërësi koston e ngritur të energjisë elektrike për konsumatorët biznesorë. Diferencimi i konsumatorëve dhe mosarritja e sigurimit të një pozite të barabartë krahasuar me konsumatorët e amvisërisë paraqet një tjetër diskriminim që bëhet përmes subvencionimit. Kjo për faktin se si një produkt i njëjtë, konsumatorët në amvisëri që shpenzojnë më shumë së 800 kWh energji elektrike në muaj duhet të paguajnë më shtrenjtë dhe me tarifa të ngritura energjinë e shpenzuar, ndërsa konsumatorët biznesorë nuk ndikohen nga tarifat e ngritura pasi këtë diferencë e mbulon subvencionimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës. Shuma e ndarë prej 100.000.000.00 € (100 milionë euro) është si rezultat i taksave të paguara nga ana e gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe subvencionimi jolinear është në kundërshtim me barazinë e konsumatorëve dhe paraqet shkelje të të drejtave të njeriut.

Subvencionimi i Qeverisë nuk është i krahasueshëm për konsumatorët përmes faturave, pasi në faturat e energjisë elektrike që pranojnë konsumatorët, subvencion i Qeverisë nuk është i qasshëm. Një gjë e tillë është në kundërshtim edhe me pikën 1.4 të nenit 38 - Obligimet e furnizuesve me obligimin e shërbimit publik, të Ligjit nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike.<sup>26</sup> Kjo pikë thekson:

*“Faturon energjinë elektrike të livruar në pajtim me çmimet e arsyeshme, lehtësisht dhe qartësisht të krahasueshme, transparente dhe jodiskriminuese.”*

Duke mos paraqitur çmimet pa subvencionimin e Qeverisë dhe me subvencionimin e Qeverisë, çmimet bëhet të pakrahasueshme e rrjedhimisht edhe fatura bie në kundërshtim me pikën e lartpërmendor të Ligjit nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike. Gjithashtu mosparaqitja në faturë e subvencionimit është në kundërshtim edhe me pikën 1.2 të nenit 4 – Të drejtat e konsumatorit, të Ligjit nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit<sup>27</sup>. Kjo pikë thekson:

*“E drejta për informim dhe edukim të konsumatorit.”*

Diskriminimi i konsumatorëve tash e sa vite bëhet edhe në aspektin e diferencimit të konsumatorëve që shfrytëzojnë energjinë elektrike, e që të njëjtët nuk e paguajnë atë. Pjesa veriore e territorit të Republikës së Kosovës, edhe pse shfrytëzojnë energjinë elektrike të prodhuar dhe të importuar nga ana e aktorëve relevantë të sektorit të energjisë të vendit tonë, nuk paguajnë për energji elektrike. Kjo paraqet shkelje dhe kundërshtim me shumë ligje të Republikës së Kosovës. Ligji nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, në nenin 45 - Reflektimi i kostos në tarifat e furnizimit, pika 2, thekson:

<sup>26</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, nen 38, e qasshme në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12744>, (qasur në mars, 2022).

<sup>27</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit, nen 4, e qasshme në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16551>, (qasur në mars, 2022).

*“Në përcaktimin e tarifave të cilat do të mblidhen nga konsumatorët fundor për furnizimin e energjisë, ndërmarrja e energjisë do të sigurojë që çmimet të cilat ngarkohen nga ajo në cilëndo kohë dhe për cilindon konsumator fundor për furnizimin e energjisë të jenë të njëjtë me çmimet të cilat janë ngarkuar nga ajo ndërmarrje e energjisë në të njëjtën kohë për konsumatorët e tjerë fundor për furnizimin e krahasueshëm me energji, pavarësisht se ku ndodhen apo banojnë këta konsumatorë fundor. Këto tarifa do të reflektojë plotësisht koston e furnizimit të energjisë elektrike për konsumatorin fundor nga ndërmarrja përkatëse e energjisë.”*

Mospagimi i obligimeve për shfrytëzimin e energjisë elektrike ndaj furnizuesit të energjisë elektrike, e në të njëjtën kohë mosndërprerja e furnizimit për këta konsumatorë, bën që konsumatorët në fjalë të jenë më të privilegjuar, e gjithashtu shkakton diskriminim për pjesën tjeter të konsumatorëve në pjesët e tjera të territorit të Republikës së Kosovës. Për më tepër, në mënyrë që të mos shkaktohen devijime në sistemin energetik të vendit tonë, pagesa e sasisë së energjisë elektrike e shfrytëzuar nga pjesa veriore e territorit të Republikës së Kosovës bëhet përmes taksave të paguara nga pjesa tjeter e qytetarëve të vendit tonë. Një gjë e tillë paraqet shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut dhe bie në kundërshtim me parimet e barazisë.

Shqyrtimi i jashtëzakonshëm i tarifave të energjisë elektrike dhe i strukturës tarifore solli ndryshime në strukturën e organizimit të sistemit energetik të Republikës së Kosovës dhe në tarifa të energjisë elektrike. Por edhe pse vendimi paraqiste ngritje të tarifave të energjisë elektrike, një gjë e tillë nuk u aplikua edhe për pjesën veriore të territorit të Republikës së Kosovës. Diskriminimi i konsumatorëve, duke bërë shtrenjtimin për shumicën e tyre, paraqet pabarazi dhe shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut.

Shtrenjtimi për një pjesë të konsumatorëve, ndërsa për një pjesë tjeter jo, paraqet shkelje edhe të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Neni 24 - Barazia para Ligjit, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës<sup>28</sup>, përkatësisht pika 2 thekson:

*“Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjeter personal.”*

Në Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji përcaktohet qartë parimi kryesor:

*“Të kenë trajtim të drejtë dhe jodiskriminues gjatë furnizimit me energji elektrike nga furnizuesit, si dhe të kenë qasje të hapur në informata nga furnizuesi.”<sup>29</sup>*

Është shkelur Rregulla për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit dhe nuk është respektuar parimi i mosdiskriminimit. Në të njëjtën kohë, në faturat e energjisë elektrike nuk është qartësuar plotësisht çështja e mbulimit të kostove të energjisë së humbur, qoftë në rrjet, qoftë në pjesën e humbjeve teknike. Konsumatorët nuk informohen si duhet në faturat e tyre në lidhje me këto kosto të fshehta.

<sup>28</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 24 – Barazia para Ligjit, e qasshme në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>, (qasur në mars, 2022).

<sup>29</sup> Zyra e Rregulatorit për Energji (2011), Rregulla për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit, Prishtinë, ZRRE.

**Konstatimet:**

1. Rritja e çmimit të energjisë elektrike mund të paraqesë probleme për përballimin e pagesës për konsumatorët, sidomos për ata në nevojë. Andaj rekomandohet të krijohet Fondi për Konsumatorët në Nevojë.
2. Për të ndihmuar në këtë aspekt, Qeveria ndau 100.000.000 EUR (100 milionë euro) për përballimin e ngritjes së çmimeve të energjisë elektrike dhe sigurimin e furnizimit me energji elektrike. Subvencionimi i tillë nga ana e Qeverisë reflekton direkt në ndryshim të çmimeve të propozuara nga ana e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRR.E).
3. Diferencimi i konsumatorëve dhe mosarritja e sigurimit të një pozite të barabartë krahasuar me konsumatorët e amvisërisë paraqet një tjetër diskriminim që bëhet përmes subvencionimit.
4. Shuma e ndarë prej 100.000.000 € (100 milionë euro) është si rezultat i taksave të paguara nga ana e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe subvencionimi jolinear është në kundërshtim me barazinë e konsumatorëve dhe paraqet shkelje të të drejtave të njeriut.

## Gjendja e të drejtave të tjera të konsumatorit në tregun e energjisë elektrike

Në tregun e energjisë elektrike në Kosovë, një numër i konsiderueshëm i shkeljeve ndaj konsumatorëve ndodhin në mënyrë të përsëritur. Këto shkelje rrjedhin kryesisht nga mungesa e zbatimit të legjislacionit aktual. Mosrespektimi i kornizës aktuale ligjore sa i përket konsumit pa njehsor, përballimit të çmimeve dhe jetesës në zona me ndotje më të lartë nga aktiviteti prodhues i energjisë elektrike janë disa nga faktorët që e gjejnë konsumatorin në Kosovë tashmë të cenueshëm nga ndonjë rritje tjetër e energjisë. Në vijim do t'i trajtojmë çështjet e sipërpërmendura dhe implikimet sa u përket të drejtave të konsumatorëve.

### *Tarifat e konsumatorëve pa njehsor në raport me inkriminimin penal*

Faturimi i konsumatorëve pa njehsor vazhdon të jetë një ndër shkeljet më të qarta të të drejtave të konsumatorëve. Ndonëse Ligji nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike përcakton:

*“Energjia elektrike e dërguar tek konsumatori apo e plasuar në sistemin e transmetimit apo të shpërndarjes nga prodhuesit matet me pajisje matëse që duhet vendosur në kufi të sistemit të transmetimit apo sistemit të shpërndarjes me konsumatorët apo prodhuesit, në përputhje me kërkesat e Kodit të Matjes, të miratuar nga Rregullatori.<sup>30</sup> (...) ndërmarrjet publike vazhdojnë të faturojnë konsumatorët në mënyrë paushalle duke shkelur kështu një parim bazë të të drejtave të konsumatorit - e drejta për mbrojtje të të drejtave ekonomike të konsumatorëve.<sup>31</sup> Një shkelje të tillë e kishte konstatuar edhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kur kishte konstatuar që “ofruesit e shërbimeve publike vazhdojnë të faturojnë konsumatorët pa njehsorë“ dhe që “faturimi duhet të bëhet në bazë të konsumit real që kalkulohet në matësin e kalibruar të konsumatorit.”<sup>32</sup>*

Faturimi pa njehsor është i ndaluar edhe me Kodin aktual të Matjes i miratuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRR.E).

*“Çdo pikë kyçëse-shkëmbyese duhet t'i ketë njehsorët e instaluar për matje...ata duhet të jenë të përshtatshëm për matjen sipas strukturës tarifore në fuqi, duke përbajtur edhe elementet e fuqisë, tarifave të aplikuara dhe sasisë aktive që kalon nëpër atë pikë të matjes.”<sup>33</sup>*

Përcaktimi në këtë kuptim i tarifave të konsumatorëve pa njehsor është krejtësisht i ndaluar nga rregullativa në vend. Në një treg të rregulluar të energjisë, siç është tregu i Kosovës, mbrojtja e konsumatorëve ndaj shkeljeve të kompanive të energjisë është edhe më i domosdoshëm sesa në një treg të parregulluar. Konsumatorët kanë të drejtë për mbrojtje ligjore për sasinë e energjisë që nuk faturohet dhe është kërkesë absolute e Kodit të Matjes që të vendoset njehsori me rastin e krijimit të marrëdhënies kontraktuese mes tij dhe operatorit të distribucionit dhe atij të furnizimit.

Një tjetër dispozitë që shkelet është Rregulla për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ku bëhet përcaktimi i kushteve të përgjithshme të furnizimit me energji, si dhe detyrat dhe obligimet e ndërmarrjeve energetike dhe të konsumatorëve. Në këtë rregull pëershkuhen parimet e përgjithshme të kyçjes (aplikimi për kyçje, oferta, marrëveshja për

<sup>30</sup> Republika e Kosovës, (2016), Ligji Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, nen 53, Prishtinë: GZRKS.

<sup>31</sup> Republika e Kosovës, (2018), Ligji Nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit, nen 4, Prishtinë: GZRKS.

<sup>32</sup> Zyra Kombëtare e Auditimit, (2019), Raport i Auditimit të Performancës, Sistemi i Përcaktimit të Tarifave të Energjisë Elektrike, Termike dhe atyre të Ujësjellësit, Prishtinë: ZKA

<sup>33</sup> Zyra e Rregullatorit për Energji, (2014), Kodi i matjes së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes,

kycje dhe furnizim) dhe shfrytëzimit të sistemit, leximit, matjes, faturimit dhe arkëtimit, si dhe shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë. Në nenin 23, kjo Rregull përcakton:

*“Faturimi i energjisë së shpenzuar zhatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënrat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Furnizuesi ose Operatori i Sistemit për konsumatorët me tarifa të rregulluara në bazë të tarifave të miratuara nga ZRRE-ja, dhe për konsumatorët e kualifikuar (me çmime të parregulluara) ashtu siç është rënë dakord në kontratën përfurnizim.”<sup>34</sup>*

### *Aspekti social - Sa është i përballueshëm nga qytetarët?*

Përballimi i çmimeve është njëri ndër faktorët kryesorë që duhet marrë parasysh gjatë përcaktimit të çmimeve.

Bazuar në aktet ligjore në fuqi, masat e duhura, si: hartimi i planeve kombëtare të energjisë, do të merren në ofrimin e përfitimeve të sigurimeve sociale për të siguruar furnizimin e nevojshëm me energji elektrike për konsumatorët në nevojë, apo sigurimin e mbështetjes për përmirësimë të eficiencës së energjisë, për trajtimin e varfërisë së energjisë, aty ku ajo identifikohet, duke përfshirë edhe në kontekst më të gjerë të varfërisë. Masat e tillë nuk do ta pengojnë hapjen efektive të tregut dhe funksionimin e tij, të rregulluar me këtë ligj, dhe të njëjtat njoftohen tek Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Njoftimet e tillë nuk përfshijnë masat e marra në kuadër të sistemit të përgjithshëm të sigurimeve sociale.<sup>35</sup>

Shqetësimet mbi pamundësinë për ta përballuar çmimin aktual të energjisë kanë shfaqur edhe aktorë të rëndësishëm institucionalë në procesin e shqyrtimit të jashtëzakonshëm të strukturës tarifore.

*“Për Presidenten e Republikës së Kosovës, objektiv kryesor mbetet respektimi i parimit të përballueshmërisë, qasjes së barabartë, dhe furnizimit të rregullt me energji elektrike.”<sup>36</sup>*

Në Strategjinë e Energjisë, varfëria energetike është theksuar shumë sipërfaqësish:

*“Konsiderohet e nevojshme që qeveria të zhvilloj Programin për mbrojtjen e konsumatorëve të cenesëshëm bazuar në një studim te thelluar në pajtim me kërkesat e Komunitetit të Enerjisë.”<sup>37</sup>*

Strategjia e Energjisë e Kosovës identifikon konsumatorët e cenesëshëm dhe obligon Qeverinë që të përcaktojë një program për mbrojtjen e tyre. Ligji i Energjisë Elektrike dhe Ligji i Gazit Natyror përdorin termin konsumatorë në nevojë duke përcaktuar që ministria përkatëse për politikat sociale të zhvillojë kritere për identifikimin e konsumatorëve në nevojë, si dhe shtrirjen e të drejtave dhe masave që synojnë mbrojtjen e këtyre konsumatorëve në përbushjen e kërkësave të tyre për energji elektrike dhe për gaz. Megjithatë, përkufizimi

<sup>34</sup> Zyra e Rregullatorit për Energji (2011), Rregulla për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit Prishtina, ZRRE

<sup>35</sup> Republika e Kosovës, (2016), Ligji nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, Prishtinë, GZBKK.

<sup>36</sup> Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës (2022), Komente nga Zyra e Presidentes e Republikës së Kosovës në Raportin Konsultativ të Zyrës së Rregullatorit për Energji mbi Shqyrtimin e Strukturës Tarifore për Konsumatorët e Rregulluar të Amvisërisë të Shërbyer nën FShU, Prishtinë, ZPRKS.

<sup>37</sup>Republikë e Kosovës (2016), Strategjia e Energjisë e Kosovës 2017-2026, Prishtinë, ZPKRS.  
[https://mc.rks-gov.net/repository/docs/Strategjia\\_e\\_energjisë\\_2017-26\\_-pdf\\_\(qasur\\_në\\_prill\\_2022\)](https://mc.rks-gov.net/repository/docs/Strategjia_e_energjisë_2017-26_-pdf_(qasur_në_prill_2022))

dhe kriteret aktuale nuk janë hartuar ende dhe nuk ka masa për t'i mbrojtur konsumatorët në nevojë.<sup>38</sup>

Në strukturën aktuale të energjisë nuk janë paraparë fare konsumatorët e ceneseshëm. Qeveria ka vendosur që përmes subvencionimit direkt në të hyrat maksimale të lejuara të zbusë efektet e rritjes së çmimit për kategori të caktuara të konsumatorëve. Megjithatë, kjo praktikë është në kundërshtim me parimet e legjisacionit të energjisë, Strategjinë e Energjisë dhe përcaktimet integruese të vendit. Adresimi i konsumatorëve të ceneseshëm dhe i varfërisë energjetike duhen bërë përmes skemave të veçanta jashtë-tarifore.

### Masat që rrjedhin nga Ligji nr. 05/L-044 për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obiliqit

Zyra e Rregullatorit për Energjinë bashkë me institucionet e tjera nuk kanë bërë asgjë për të siguruar zbatimin e dispozitave të Ligjit nr. 05/L-044 për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obiliqit. Dispozitat për çmime të veçanta të energjisë elektrike apo për ulje të çmimit të energjisë elektrike nuk kanë gjetur zbatim deri më tanë.



#### Zyra e Kryetarit/Kabinet Predecednika/ Office of the Mayor

Datë/Data/Date:	29 janar 2022
Nga/Od/From:	Xhafer Gashi – Krytar i Komunës
Për/Za/To:	z.Glauk Konufca- Krytar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisionit Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, z.Albin Kurti – Kryeministër i Republikës së Kosovës znj.Artana Rizvanolli- Ministre e Ekonomisë Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë në Kosovë
Tema/Subjekat/Subject	Ligi për Obiliqin, -koutë më të ultë të energjisë elektrike

Foto 1. Adresimi i kryetarit të komunës së Obiliqit për institucionet sa u takon dispozitave në ffalë

Në fillim të vitit, kryetari i komunës së Obiliqit, z. Xhafer Gashi, i ishte drejtuar me një letër Qeverisë, Kuvendit dhe ZRR-ësë për të kërkuar modalitetet për zbatimin e Ligjit për Obiliqin sa i përket përcaktimit të një kostoje më të ulët të çmimeve të energjisë.

Megjithatë, ende nuk ka pasur një zgjidhje lidhur me këtë problem. Duhet theksuar se ligji aktual përcakton qasjen jodiskriminuese mes konsumatorëve të rregulluar, subvencionimi përmes zvogëlimit të tarifave mund të jetë i pazbatueshëm për shkak se bie ndesh me legjisacionin aktual në fushën e energjisë. Sidoqoftë, rishqyrtimi i pakos së legjisacionit për energji u jep shans institucioneve t'i bëjnë harmonizimet e nevojshme.

<sup>38</sup> Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (2021), Study on Addressing Energy Poverty in the Energy Community Contracting Parties, i qasshëm në [https://www.energy-community.org/dam/jcr:f201fefd-3281-4a1f-94f9-23c3fce4bbf0/DOOREIHP\\_poverty\\_122021.pdf](https://www.energy-community.org/dam/jcr:f201fefd-3281-4a1f-94f9-23c3fce4bbf0/DOOREIHP_poverty_122021.pdf) (qasur në prill, 2022).

## Konstatimet:

1. Faturimi i konsumatorëve pa njehsor vazhdon të jetë një ndër shkeljet më të qarta të të drejtave të konsumatorëve dhe është krejtësisht i ndaluar nga rregullativa në vend. Konsumatorët kanë të drejtë për mbrojtje ligjore për sasinë e energjisë që nuk faturehet dhe është kërkesë absolute e Kodit të Matjes që të vendoset njehsori me rastin e krijimit të marrëdhënies kontraktuese mes tij dhe operatorit të distribucionit dhe atij të furnizimit.
2. Në legjislacionin kosovar, varfëria energetike është theksuar shumë sipërfaqësisht. Edhe pse Strategja e Energjisë e Kosovës identifikon konsumatorët e ceneshëm dhe obligon Qeverinë që të përcaktojë një program për mbrojtjen e tyre, ende nuk janë hartuar kriteret dhe masat për konsumatorët në nevojë.
3. Nuk mund të zbatohet Ligji për Obiliqin, por Fondi i Konsumatorëve në Nevojë mund t'i ndihmojë jashtëzakonisht anëtarët e komunës.

## Vlerësimet e përgjithshme të Avokatit të Popullit

Institucionet e Kosovës është e nevojshme t'i orientojnë politikat e sektorit të energjisë në përgjithësi dhe shërbimet e energjisë elektrike në veçanti drejt mbrojtjes së konsumatorëve. Një politikë e tillë do ta përgatiste Kosovën drejt tregut të liberalizuar dhe tranzicionit energetik. Vodosja e konsumatorëve dhe e drejtave të njeriut në qendër të tranzicionit, do t'i ndihmonte shtetit t'i zbuste shumë prej sfidave në procesin e tranzicionit dhe do ta bënte këtë të fundit gjithëpërfshirës dhe të drejtë.

Avokati i Popullit vlerëson të nevojshme që i gjithë procesi i përcaktimit të strukturës tarifore dhe i lartësisë së tarifave të rikthehet në pikën zero. Çdo proces i ardhshëm të ndiqet nga parimet e mosdiskriminimit etnik apo regional dhe nga barazia e konsumatorëve në tregun e rregulluar. Gjithashtu, diskriminimi bazuar në nivelin e konsumit duhet të hiqet dhe ZReE-ja në bashkëpunim me Qeverinë, me Agjencinë e Eficiencës së Energjisë dhe me Fondin e Eficiencës të gjejnë mekanizma të tjera të rritjes së vetëdijes apo nxitjes për eficiencë pa kufizime të niveleve të konsumit dhe dallim të çmimeve për shfrytëzim të një rehatie që duhet paguar për njësinë e shpenzimit, jo për volumin e tij.

E vlerësojmë të nevojshme që Qeveria ta themeloi Fondin e Konsumatorëve në Nevojë. Pakoja e re e paralajmëruar e legjislacionit në fushën e energjisë ta përcaktojë qartësisht kufirin e varfërisë energetike dhe ta ndërlidhë atë me të hyrat familjare, në mënyrë që mbështetja për konsumatorët e ceneshëm të jetë e qëndrueshme, dinamike dhe të reflektojë situatën socio-ekonomike të tyre pa diskriminuar të tjerët.

Po ashtu është e rëndësishme të fuqizohen kapacitetet monitoruese për ta ndaluar faturimin pa njehsor. Zyra e Rregulatorit për Energji duhet të sigurojë që kapacitetet e stafit për monitorim dhe menaxhim të ankesave të qytetarëve shtohen në mënyrë që të mos lejohen faturime paushall dhe pa njehsor të kalibruar që matin energjinë e shpenzuar. Në pakot e reja të paralajmëruara të legjislacionit të fushës së energjisë, të fuqizohen dispozitat që ndalojnë ZRR-ënë dhe ndërmarrjet e energjisë nga përcaktimi i tarifave pa njehsor apo aplikimi i faturimit paushall.

ZRR-E-ja bashkë me Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe aktorët e tjera, të cilët punojnë për të drejtat e konsumatorëve, ta përcaktojnë një dizajn të ri të faturës së energjisë elektrike. Ky dizajn do të duhej që në radhë të parë të bënte transparencën e plotë të faturës së energjisë, përfshirë të gjitha kostot e humbjeve, të sqaronte në gjuhë të kuptueshme për konsumatorin dallimet e niveleve të faturimit si dhe të rriste informimin e qytetarëve mbi kostot e fshehura në faturën aktuale.

Në shqyrtimet e pakos së tretë të legjislacionit të energjisë, është e nevojshme të bëhet harmonizimi i ligjeve të energjisë me Ligjin për Obiliqin ose anasjelltas. Duhet kuptuar që lehtësirat në uljen e çmimit të rregulluar janë vështirë të zbatueshme pasi shkaktojnë diskriminim mes konsumatorëve, porse modalitetë mund të gjinden përmes Fondit të Konsumatorëve në Nevojë. Ekzistojnë dy modele që ne i shohim për zbatimin e qëllimit të normës së Ligjit për Obiliqin:

- a) Fondi i Konsumatorëve në Nevojë - me themelimin e Fondit të Konsumatorëve në Nevojë, ku qytetarëve të Obiliqit do t'u njihej statusi i konsumatorëve të cenesës së dëshmit do të kishin të drejtë të përfitonin një përqindje të subvencionimit të faturës. Ky model nuk do ta cenonte tregun e lirë të energjisë pasi në një treg të hapur në të ardhmen të gjithë furnitorët mund të konkuronin me çmime pa llogaritur diferençën e subvencionimit që do të paguhej nga Qeveria.
- b) Krijimi i një ndërmarrjeje publike lokale të furnizimit me energji, e cila do të licencohej për aktivitete të furnizimit dhe që do t'i furnizonte banorët e Obiliqit me çmime më të ulëta. Në këtë model mund të kontribuonte edhe kuadri aktual i ndërmarrjeve publike që ekzistojnë dhe do të mundë të lidhnin marrëveshje të shitblerjes me ndërmarrjen e furnizimit. Natyrisht që përkthimët duhet pasur parasysh që mund të ndikojë në parimet e konkurrencës së lirë dhe eventualisht një proces konkurruesh mes furnizuesve mund të përcaktonte furnizuesin që do ta kryente këtë shërbim për konsumatorët e cenesës së Obiliqit.

## Përfundime

Republika e Kosovës, si nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, është e përkushtuar dhe ka marrë obligime për një treg të liberalizuar të energjisë, një treg që avancon konkurençën, transparencën dhe mbron të drejtat e konsumatorëve. Për të arritur deri tek ky treg, Kosova ka miratuar një Udhëzues të Liberalizimit të Tregut, i cili përcakton afate kohore deri kur grupet e konsumatorëve, të lidhura në tension të ndryshëm, duhet të kalojnë në tregun e hapur. Kosova gjithashtu është e obliguar me legjislacionin horizontal përgarantimin e të drejtave të konsumatorit, përfshirë të drejtën në informim dhe të drejtën përmbrojtje të interesave ekonomike të konsumatorëve.

Në Kosovë ka pasur një proces historik të vendosjes së strukturës tarifore dhe rregullimi i çmimeve përmes bllok-tarifave ka qenë një praktikë e pranishme edhe në të kaluarën. Para vitit 2017, karakteri i strukturës tarifore me blloqe ka qenë më social duke paraparë edhe shkallë të çmimit nën koston e prodhimit, gjë që është ndaluar me Ligjin për Rregulatorin e Energjisë dhe me Ligjin për Energjinë Elektrike. Struktura tarifore e vitit 2021 është gjithashtu unike për shkak të kufirit të konsumit deri në 800 kw dhe mbi 800 kw, gjë që nuk ka qenë para vitit 2017.

Bllok-tarifa në sistemin tonë të brendshëm nuk është paraparë me legjislacion, por përkundrazi, dispozitat e Ligjit për Energjinë, të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, që rrjedhin nga pakoja e tretë evropiane e legjislacionit për energjinë, inkurajojnë çmime të çrrregulluara dhe konkurrencë në treg. Për më tepër, ZRrE-ja, ndonëse arsyeton vendimin me nevojën për stimuj të eficiencës së energjisë, neni 20 i Ligjit për Eficiencën e Energjisë përcakton vetëm obligimin që ZRrE-ja të ketë parasysh stimuj për përmirësimin e eficiencës së rrjetit dhe atë ndaj operatorëve të tregut të energjisë dhe jo ndaj kategorive të ndryshme të konsumatorëve bazuar në konsum.

Vendimi për faturim retroaktiv dhe mosreflektimi i saj në faturë si dhe mosreflektimi i nivelit të subvencionimit në faturë përbën gjithashtu shkelje të së drejtës së konsumatorëve për informim.

Vendimi i ZRrE-së ka elemente të diskriminimit dhe të trajtimit të pabarabartë ndaj konsumatorëve. Tarifat e ndryshme e të bazuara në nivel të konsumit të energjisë elektrike janë në kundërshtim me nenin 47 të Ligjit nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, ku theksohet domosdoshmëria që tarifat të kenë karakter jodiskriminues. Vendimi i ZRrE-së për t'i përjashtuar konsumatorët e veriut të Kosovës nga shtrenjtimi i rrymës krijon situatë të diskriminimit të pjesës tjetër të konsumatorëve. Gjithashtu subvencionimi mes kategorive të konsumatorëve me çmime të rregulluara vë gjithashtu ZRrE-në në pozicion diskriminues.

Bllok-tarifa është një praktikë e tregjeve të reja të energjisë dhe e tregjeve me karakter qendror dhe të pa decentralizuar. Pakoja e tretë e legjislacionit të energjisë vë theksin te liberalizimi i tregut dhe heqja e diskriminimit mes kategorive të konsumit. Mbështetja ndaj konsumatorëve të cenesëshëm dhe të kategorive të tjera sociale bëhet përmes skemave të tjera dhe jodiskriminuese dhe jo përmes subvencionimit të drejtpërdrejtë në tarifë. Në asnjërin prej vendeve të BE-së bllok-tarifa nuk aplikohet dhe ruhet karakteri i trajtimit të barabartë të konsumatorëve.

Faturimi pa njehsor dhe përcaktimi i një tarife të konsumit për konsumin pa njehsor bie ndesh me legjislacionin në fushën e energjisë, në fushën e mbrojtjes së konsumatorit dhe me vetë rregullativën e Zyrës së Rregulatorit për Energji. Konsumatorët kanë probleme edhe me cilësinë e shërbimit, por edhe me faturimin paushall dhe me faturimin që nuk korrespondon me sasinë e shpenzuar të energjisë. Andaj duhet që të fuqizohen kapacitetet monitoruese për ta ndaluar faturimin pa njehsor. Zyra e Rregulatorit për Energji duhet të sigurojë që kapacitetet e stafit për monitorim dhe menaxhim të ankesave të qytetarëve shtohen në mënyrë që të mos lejohen faturime paushall dhe pa njehsor të kalibruar që matin energjinë e shpenzuar. Në pakot e reja të paralajmëruara të legjislacionit të fushës së energjisë, të fuqizohen dispozitat që ndalojnë ZRrE-në dhe ndërmarrjet e energjisë nga përcaktimi i tarifave pa njehsor apo aplikimi i faturimit paushall.

Nuk ka një përcaktim të qartë në legjislacionin tonë dhe në kornizën e politikave sa i përket varfërisë energetike dhe se kush mund të konsiderohet konsumator i cenesëshëm. Një ndër çështjet kryesore që një ndryshim kaq rrënjosor i strukturës tarifore dhe i çmimeve do të duhej ta kishte parasysh është çështja e përballimit të çmimeve. Megjithatë, pa një mekanizëm adekuat, siç e ka paraparë ligji, nuk mund të zbuten efektet e rritjes për ata që kanë më së shumti nevojë. Në të kundërtën, përfundohet duke diskriminuar. Prandaj Qeveria duhet urgjentisht ta themelojë Fondin e Konsumatorëve në Nevojë. Pakoja e re e paralajmëruar e legjislacionit në fushën e energjisë të përcaktojë qartësisht kufirin e varfërisë

energetike dhe ta ndërlidhë atë me të hyrat familjare, në mënyrë që mbështetja për konsumatorët e ceneshem të jetë e qëndrueshme, dinamike dhe të reflektojë situatën socio-ekonomike të tyre pa diskriminuar të tjeter.

Ligji për Obiliqin, në pjesën e vendosjes së tarifave më të ulëta të energjisë për konsumatorët fundorë, nuk ka gjetur zbatim deri më tanë dhe ndonëse qytetarëve të Obiliqit u ishte krijuar pritja se do të kishte çmime të reduktuara të energjisë. Ligji bie ndesh me legjislacionin aktual në fushën e energjisë dhe nuk ka pasur përpjekje për harmonizimin e tyre deri më tanë. Në shqyrtimet e pakos së ardhshme të legjislacionit të energjisë duhet të bëhet harmonizimi i ligjeve të energjisë me Ligjin për Obiliqin ose anasjelltas. Duhet kuptuar që lehtësirat në uljen e çmimit të rregulluar janë vështirë të zbatueshme, pasi shkaktojnë diskriminim mes konsumatorëve, porse modalitetë mund të gjinden përmes Fondit të Konsumatorëve në Nevojë.

Vendimi i ZRrE-së për shtrenjtim seleksionues të çmimit të energjisë për vendosje të bllok-tarifave dhe vendimi për subvencionim gjithashtu seleksionues bien në kundërshtim me parimet e vendosjes së tarifave të përshkruara në legjislacionin vendor, me legjislacionin e Komunitetit të Energjisë në Vjenë dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit. Masat afirmative të vendosura në vendimin e ZRrE-së nuk i gjeljnë njëjtë të gjithë konsumatorët me çmime të rregulluara dhe nga shtrenjtimi nuk preken njëjtë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Me nderime,

Naim Qelaj  
Avokat i Popullit

